

Nr. regj.14836/12

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCII ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	DPK/DMP
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot Br. Prot Prot No	03-4011/12
Data Datum Date	06.11.2012
PRISHTINE	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Vidoje Tonic nga Lypjani, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 te Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave te Zyrtareve te Larte Publik nr. 03/L-151, e ne baze te nenit 73.73.195, 199 te Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 24.09.2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Vidoje Mita Tonic, i lindur më 10.06.1947 në Lypjan, ku edhe tani jeton ne Rr. ish Sitnices nr. 22 ne Lypjan, i martuar baba i dy fëmijëve, Zëvendës drejtor ne Ministrinë e Administratës Publike ne Prishtine, fakultetin e kryer, i gjendjes se ulet ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me si Zyrtar i larte Publik, ne Zëvendës drejtor ne Ministrinë e Administratës Publike ne Prishtine, nuk e ka bere deklarimin e rregullt te gjendjes se pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 te ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtareve te Larte Publike**, andaj te pandehurit për ketë kundërvajtje i shqiptohet,

D E N I M I

Me gjobë në shumë prej **1000 (njëmijë)** Euro. Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po qe se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njehta do ti zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi. Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencinë Kundër Korrupsionit ne Prishtine, parashtroi kërkesën nr. 01 1618 të dt. 30.04.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj te pandehurit te shënuar për kundërvajtjen e precizuar si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen ne pyetje te pandehurit, me ndihmën e përkthyesit te kësaj Gjykate Sadik Osmani, i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se si Zëvendës Drejtor ne Ministrinë e Administratës Publike ne Prishtine, nuk e ka bere deklarimin e pasurisë, pasi qe ka qene i sëmure. Me tej shton se formularin për deklarimin e pasurisë e ka pranuar veten ne Gjuhen Shqipe, kështu deri sa është përkthyer ne Gjuhen Serbe është dashur kohe.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari morri në pyetje dëshmitarin –Enis Sadikun, Zyrtar ne Agjencinë kundër Korrupsionit ne Prishtinë, cili ka deklaruar: se mbetet ne tërësi pran kërkesës për kundërvajtje ndaj te pandehurit, pasi i pandehuri nuk e ka respektuar aftin ligjor për deklarimin e pasurisë, më te tej shton se ne çdo vend te punës i dërgojnë formularët ne dy gjuhet ne te njëjtën kohe, dhe për ketë si dëshmi ka prezantuar dokumentin e dt. 01.03.2012 te dt. 2012.

03-4011/12/02
Sugj

Nga te dhënat ne kërkesë, vlerësimin i deklaratës se te pandehurit, ushtruesit te Kërkesës Enis Sadiku, Zyrtar ne Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe baze të dhënave te parashtruara në kërkesë, shiqimit të shkresave të lendes dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është denuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kurse mbrojtjen e të pandehurit e hudhi si të pa bazë. Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK morri si rrethanë lehtësuese gjendjen e tij shëndetësore, andaj të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit te i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.

